

# Udhëzues për zyrtarë të shërbimeve sociale për ndihmë viktimave të dhunës në familje



*Kompilacion i instrumenteve relevante ndërkombëtare  
dhe legjislacionit të Kosovës për qendrat për punë sociale*

Nëntor 2021



# **Udhëzues për zyrtarë të shërbimeve sociale për ndihmë viktimave të dhunës në familje**

*Kompilacion i instrumenteve relevante ndërkombëtare dhe  
legjislacionit të Kosovës për qendrat për punë sociale*

# Pasqyra e përmbajtjes

<b>I. Hyrje</b> .....	<b>5</b>
Çfarë është dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje? .....	7
Format e dhunës ndaj grave .....	8
Kush janë viktimat e dhunës në familje? .....	9
Shenjat identifikuese që mund të ndihmojnë në dallimin e dhunës me bazë gjinore .....	10
Faktorët e rrezikut .....	11
Ndikimi i dhunës tek gratë.....	12
Fëmijët viktimat të dhunës në familje.....	13
<b>II. Korniza ligjore dhe e politikave e Kosovës për dhunën në familje</b> .....	<b>15</b>
<b>III. Roli i zyrtarëve të shërbimit social në trajtimin e rasteve të dhunës në familje</b> .....	<b>17</b>
Roli dhe përgjegjësitë e qendrave për punë sociale në trajtimin e rasteve të dhunës në familje .....	17
Roli i zyrtarëve të shërbimit social për trajtimin e fëmijëve viktimat/të mbijetuar të dhunës në familje .....	23
<b>IV. Shtojca: Instrumentet dhe parimet kryesore ndërkombëtare mbi dhunën ndaj grave</b> .....	<b>25</b>

## Shkurtesat

<b>QPS</b>	Qendra për Punë Sociale
<b>KPK</b>	Kodi Penal i Kosovës
<b>DhF</b>	Dhuna në familje
<b>DHBGJ</b>	Dhuna me bazë gjinore
<b>KeS</b>	Konventa e Stambollit
<b>DHPI</b>	Dhuna nga partneri intim
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>DHNG</b>	Dhuna ndaj grave

# I. Hyrje

**Qendra për Punë Sociale (QPS)** është institucion profesional dhe administrativ komunal, me përgjegjësi të ofrimit të mbrojtjes së qytetarëve në nevojë sociale, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve familjare dhe sociale për të gjitha viktimat e referuara ose të identifikuara të dhunës në familje.

Mandati i QPS-së përfshin caktimin e Kujdestarin Ligjor që përfaqëson interesat ligjorë të viktimave nën moshën 18 vjeç. Kujdestari Ligjor jep mendim për vendimet e rëndësishme në lidhje me shëndetin, arsimin dhe pasuritë për fëmijët viktimë të dhunës në familje (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) dhe viktimat e rritura pa zotësi juridike.

**Zyrtar i Shërbimeve Sociale** do të thotë profesionist i kualifikuar i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, në fushat e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, juridikut, pedagogjisë ose disiplinave tjera, të lidhura ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, licencuar dhe regjistruar në regjistrin e Këshillit të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare.<sup>1</sup>

Roli i zyrtarit të shërbimit social është të **ndihmojë viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje (DHF) të kuptojnë përvojën e dhunshme, të ballafaqohen dhe të rimëkëmben** nga trauma e përjetuar, **të shpjegoj mundësitë në dispozicion** të viktimës/të mbijetuarit të DHF-së ashtu që viktimë/i mbijetuarit i DHF-së të mund të marrë vendim të informuar për atë që dëshiron të bëjë në këto rrethana të parashikuara.

*Zyrtari i shërbimit social ka për obligim të informojë dhe të këshillojë viktimat/të mbijetuarit e DhF-së, në pajtim me kornizën ligjore dhe të politikave të vendosura për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje. Zyrtari i shërbimit social duhet që të referojë dhe të përcjellë me shërbimet e tjera derisa viktimë/të mbijetuarit e DHF-së të riintegrohen në shoqëri.*

Është shumë e rëndësishme që zyrtari i shërbimit social të zbatojë një qasje të përqendruar tek viktimë në të gjitha fazat e trajtimit dhe menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Kjo do të thotë përkushtim në mbrojtje të viktimave, ndjeshmëri ndaj problemeve të viktimave, si dhe përgjegjshmëri ndaj nevojave të viktimave.

Zyrtari i shërbimit social duhet të ofrojë mbështetjen e nevojshme për të cilën viktimë mund të ketë nevojë, me qëllim të zbutjes së shqetësimit të tyre moral, si dhe të mundësojë fuqizimin dhe riintegrimin e viktimës.

---

<sup>1</sup> Po aty. Neni 1 (1.3(i)), Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

**Qëllimi i këtij udhëzuesi** është të **ndihmojë** zyrtarët e shërbimit social në **trajtimin e viktimave/të mbijetuarve** të dhunës në familje. Udhëzuesi për **instrumentet përkatëse ndërkombëtare dhe legjislacionin e Kosovës për Qendrat për Punë Sociale në trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje** është hartuar në bazë të *Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje<sup>2</sup> (KeS), Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, pjesë e reagimit multi-sektorial ndaj Procedurave Standarde të Veprimit për dhunën me bazë gjinore - publikimi i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë<sup>3</sup> si dhe korniza ligjore dhe e politikave të Kosovës për dhunën në familje<sup>4</sup>. Ky udhëzues ofron informata për konceptet kryesore të dhunës ndaj grave (DHNG); format e DHNG-së; dhunës në familje (DHF); viktimave të dhunës në familje; abuzimit në familje; modeleve të pushtetit dhe kontrollit mbi gratë si dhe ciklit të dhunës dhe ndikimit të DHNG-së mbi viktimat. Për më tepër, ofrohen edhe disa informata themelore se si të adresohen rastet e dhunës në familje, përfshirë:*

- Identifikimi
- Referimi
- Mbrojtja dhe
- Koordinimi i qasjeve ndaj dhunës në familje.

Dhuna në familje është çështje e ndjeshme, prandaj duhet të trajtohet me kujdes, ndjeshmëri dhe konfidencialitet nga zyrtarët e shërbimit social. Zyrtarët e shërbimit social janë çelës në parandalimin dhe mbrojtjen nga DhF, sepse shumë shpesh janë pika e parë e kontaktit për viktimat kur ato kërkojnë ndihmë. Prandaj, zyrtarët e shërbimeve sociale duhet të zbatojnë qasjen me viktimën në qendër, si dhe mekanizmat e bashkëpunimit dhe referimit ndërinstytucional.

Bazuar në rastet e DhF-së të raportuara në Sektorin e Dhunës në Familje të Policisë së Kosovës, 80 për qind e rasteve të raportuara të DhF-së janë gra dhe vajza, ndërsa 20% e rasteve të raportuara të DhF-së shënjestrojnë burra dhe djem.<sup>5</sup> Pandemia COVID-19 e rrjedhimisht edhe bllokimet dhe kufizimet e lëvizjes, çuan në një **rritje mesatare prej rreth 8 për qind në rastet e raportuara të dhunës në familje në të gjithë Kosovën** mes janarit dhe dhjetorit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2019<sup>6</sup>. Njëkohësisht, shifrat ndryshojnë ndjeshëm në varësi të rajonit, ndërsa shumica e rasteve mbeten të pa raportuara<sup>7</sup>.

<sup>2</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), 01 gusht 2014. Gjetet tek <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210>. (Qasur më 28 dhjetor 2020).

<sup>3</sup> [https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs\\_psycho-social%20services\\_eng.pdf](https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs_psycho-social%20services_eng.pdf). (Qasur më 28 dhjetor 2020)

<sup>4</sup> Shih Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga dhuna në familje, 1 qershor 2010. Shih edhe *Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë* (2013). Gjetet tek: <https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20t%C3%AB%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf>. (Qasur më 28 dhjetor 2020).

<sup>5</sup> Raportet e Policisë së Kosovës tregojnë se gjatë vitit 2019, janë raportuar 1915 raste të dhunës në familje, ku përfshiheshin 1978 viktimat të dhunës në familje (1592 gra dhe 386 burra), në vitin 2020, në PK janë raportuar 2069 raste të dhunës në familje që përfshinin 2101 viktimat të dhunës në familje (1632 gra dhe 469 burra).

<sup>6</sup> Raportet e Policisë së Kosovës tregojnë se 2101 viktimat të dhunës në familje janë raportuar nga janari deri në dhjetor 2020, që janë 123 viktimat më shumë se në 2019.

<sup>7</sup> Sipas "Anketës së Misionit të OSBE-së në Kosovë *për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*" (2019), vetëm 2% e viktimave të intervistuar kanë kontaktuar Policinë e Kosovës menjëherë pas incidentit më të rëndë të dhunës.

**Nivel i ulët i raportimit në Policinë e Kosovës dhe shërbimet sociale** – sipas anketës së OSBE-së për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë, 2019<sup>8</sup>, vetëm dy për qind të grave kanë raportuar në polici incidentet më të rënda të tyre të dhunës nga partneri aktual, **tre për qind – te shërbimet sociale** dhe pothuajse asnjë nuk ka raportuar të kenë kontaktuar strehimoret e grave apo shërbimet e tjera të specializuara.

## Çfarë është dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje?<sup>9</sup>

### Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj Grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), neni 3 - Përkufizimet

"**Dhuna me bazë gjinore ndaj grave**" do të thotë dhunë që drejtohet ndaj një gruaje sepse **është grua**, ose që prekë gratë në mënyrë joproporcionale".<sup>10</sup>

"**Dhuna ndaj grave**" është shkelje e të drejtave të njeriut dhe formë e diskriminimit ndaj grave. Nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të grave, duke përfshirë kërcënimet për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngimin ose mohimin arbitrar të lirisë, pavarësisht se a ndodh në **jetën publike ose private**<sup>11</sup>.

"**Dhuna në familje**" nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike, të cilat ndodhin brenda familjes ose bashkësisë familjare ose ndërmjet bashkëshortëve apo partnerëve aktualë dhe ish-bashkëshortëve, pavarësisht nëse kryesi ka bashkëjeton apo ka bashkëjetuar në të njëjtën banesë me viktimën<sup>12</sup>.

**Dhuna në familje** është një nga format më serioze dhe më të përhapura të dhunës ndaj grave.

**Ligji për Mbrojtjen nga dhuna në familje**,<sup>13</sup> parasheh që marrëdhënia familjare konsiderohet se ekziston midis personave nëse ata:

- 1.1.1. janë të fejuar apo ishin të fejuar;
- 1.1.2. janë të martuar apo ishin të martuar;
- 1.1.3. janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore;
- 1.1.4. bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;
- 1.1.5. përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë;

<sup>8</sup> Shih Anketën e OSBE-së për Mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë (2019).

<sup>9</sup> Shih Përkufizimet - neni 3, Konventa e Stambollit.

<sup>10</sup> Shih përkufizimin e Dhunës me bazë gjinore - neni 3.d, Konventa e Stambollit.

<sup>11</sup> Shih përkufizimin e dhunës ndaj grave - neni 3.a, Konventa e Stambollit.

<sup>12</sup> Shih përkufizimin e dhunës në familje - neni 3.b, Konventa e Stambollit.

<sup>13</sup> Shih nenin 2, paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga dhuna në familje, gusht 2010.



- 1.1.6. janë prindër të një fëmije të përbashkët;
- 1.1.7. janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare;

## Format e dhunës ndaj grave

**Dhuna fizike** është sjellje e qëllimshme e kryerjes së akteve të dhunës fizike ndaj një personi tjetër.<sup>14</sup>

**Dhuna psikologjike** është sjellje e qëllimshme e dëmtimit serioz të integritetit psikologjik të një personi përmes detyrimit ose kërcënimeve<sup>15</sup>.

**Dhuna seksuale përfshirë përdhunimin** mbulon gjitha penetrimet pa pëlqim, vaginale, anale, orale të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër me ndonjë pjesë të trupit apo objekt.<sup>16</sup>

**Përndjekja** është sjellje e qëllimshme e ndërmarrjes së përsëritur të akteve kërcënuese drejtpërdrejt ndaj një personi tjetër, duke i shkaktuar atij apo asaj frikë për sigurinë e saj ose të tij. Përndjekja mund të ndodhë me ose pa kontakte fizike, mund të përfshijë kërcënime dhe ngacmime, mund të jetë në internet ose fizikisht ose mund të përfshijë akte të spiunimit apo përcjelljen e viktimës.<sup>17</sup>

**Martesa e detyruar** i referohet veprimit të qëllimtë të detyrimit të një të rrituri ose fëmije të lidhë martesë. Akti i joshjes së një të rrituri ose një fëmije në territorin e një pale ose shteti tjetër nga ai i vendbanimit të saj apo tij me qëllim të detyrimit të të rriturit/fëmijës në martesë. **Është ngushtë e lidhur me martesën e fëmijëve apo martesën e hershme, kur fëmijët hyjnë në martesë para arritjes së moshës minimale për martesë.**<sup>18</sup>

<sup>14</sup> Shih nenin 35 - Dhuna fizike, Konventa e Stambollit.

<sup>15</sup> Shih nenin 33 - Dhuna psikologjike, Konventa e Stambollit.

<sup>16</sup> Shih nenin 36 - Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin, Konventa e Stambollit.

<sup>17</sup> Shih nenin 34 - Përndjekja, Konventa e Stambollit.

<sup>18</sup> Sipas Ligjit Nr. 2004/32, Ligji për Familjen i Kosovës, neni 15 dhe neni 16. Moshë madhore fitohet me të mbushur 18 vjet. Gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore.

## Kush është viktimë e dhunës në familje?

ÇDOKUSH MUND TË JETË VIKTIMË!

Statistikat kanë treguar se **shumica e viktimave janë gra dhe vajza të reja në Kosovë**.<sup>19</sup> Të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë beqare, nënat vetëushqyese, viktimat e dhunës seksuale dhe viktimat e trafikimit me njerëz mund të jenë po ashtu viktima të dhunës në familje. Gjithsesi, edhe burrat edhe gratë mund të jenë viktima të dhunës në familje.

Fëmijët në shtëpitë ku ka dhunë në familje automatikisht konsiderohen viktima.<sup>20</sup>

**Pjesëtarët e grupeve të pakicave** mund të kenë vështirësi në raportimin e dhunës për shkak të paragjytimeve shoqërore me të cilat ballafaqohen. Personat me aftësi të kufizuara janë posaçërisht të ekspozuar ndaj dhunës në familje, sepse kanë më pak të ngjarë të raportojnë dhunën dhe të kërkojnë ndihmë.

**Gratë në zonat rurale** kanë qasje të kufizuara në shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe të specializuara të DHF-së (si mbështetja sociale, ndihma policore, shërbimet shëndetësore dhe strehimoret e grave). Gratë më të moshuara kanë më shumë gjasa të jenë të varura nga partnerët, si financiarisht ashtu dhe emocionalisht, por edhe në rrezik diskriminimi nga shërbimet përkatëse, gjë që e bën tejet të vështirë largimin e tyre nga kjo marrëdhënie e dhunshme<sup>21</sup>.

KRYESIT zakonisht janë anëtarë meshkuj të familjes ose partnerë intimë meshkuj<sup>22</sup>.

---

<sup>19</sup> Raportet e Policisë së Kosovës tregojnë se në vitin 2019, ishin raportuar 1978 raste të dhunës në familje (1592 gra dhe 386 burra). Më 2020, janë raportuar 2,101 raste të dhunës në familje (1632 gra dhe 469 burra).

<sup>20</sup> Shih Preambulën, Standardi i Konventës së Stambollit (që njeh faktin që fëmijët janë viktima të dhunës në familje, edhe si dëshmitarë të dhunës në familje).

<sup>21</sup> Shih *Studimi i OSBE-së për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë* (2019), faqe 75 dhe 76.

<sup>22</sup> Po aty. Faqe 37. Më se gjysma e grave (54%), që kanë ose kanë pasur partner, tregojnë se kanë përjetuar dhunë nga këto partnerë.

## Shenjat identifikuese që mund të ndihmojnë në dallimin e dhunës me bazë gjinore

Efektet më të shpeshta psikologjike dhe psikosomatike:<sup>23</sup>

- ✓ Ndjenja e fajit, turpit, zemërimit, trishtimit, dëshpërimit, pafuqisë, pashpresës, zbrazëtisë, mungesës së forcës, ngufatjes.
- ✓ Ndjenja e vazhdueshme e rrezikimit (ndjenjë e vazhdueshme e alarmimit).
- ✓ Frika nga gjithçka, si dhe moskujdesi për veten dhe të tjerët, si dhe vështirësi në përqendrim, por edhe vetmi e thellë (tëhuajsim).
- ✓ Humbja e aftësisë për të bërë plane dhe mungesa e iniciativës, frika e përballjes si e vetme me jetën, frika nga kuptimi dhe interesimi për jetë, si dhe mungesa e vetëvlerësimit dhe shqetësimi, nervozizmi.
- ✓ Sëmundje të zemrës.
- ✓ Çrregullime të tretjes.
- ✓ Çrregullime gjumi dhe çrregullime në të ngrënë.
- ✓ Kokëdhimbje, dhimbje muskulore dhe abuzim me substanca<sup>24</sup>

Efektet specifike psikologjike më të shpeshta në rast të dhunës seksuale:

- ✓ Përsiatja.
- ✓ Mendime të përsëritura (kujtesa e traumës papritmas kthehet në mënyrë tronditëse).
- ✓ Reagime fizike (dridhje apo të fikët kur kujtohet ngjarja traumatike).
- ✓ Përsëritje skenash në memorie (flashback).
- ✓ Makthe.<sup>25</sup>

---

<sup>23</sup> Shih nenin 37 - Martesat e detyruara, Konventa e Stambollit.

<sup>24</sup> Shih *Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, pjesë e reagimit multi-sektorial ndaj DHBGJ-së - Procedurat Standarde të Veprimit*, Zyra Rajonale e UNFPA-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (UNFPA EECARO), 2015. (f.10).  
Gjendet tek: [https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs\\_psycho-social%20services\\_eng.pdf](https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs_psycho-social%20services_eng.pdf). (Qasur më 28 dhjetor 2020).

<sup>25</sup> Po aty. (f.11).

## Faktorët e rrezikut<sup>26</sup>:

Për të siguruar mirëfilli sigurinë e viktimës, është e nevojshme të kuptohen faktorët e rrezikut.

- ✓ Aktet/incidentet të mëparshme të DHBGJ-së ndaj viktimës/të mbijetuarit, fëmijëve ose anëtarëve të tjerë të familjes.
- ✓ Historia e keqtrajtimit, format dhe modelet e dhunës së përdorur, dënimet e mëparshme apo raportimet në polici, armët e përdorura janë tregues për të vlerësuar rrezikun.
- ✓ Sjellja e dhunshme jashtë familjes.
- ✓ Ndarja dhe shkurorëzimi janë periudha me rrezikshmëri të lartë.
- ✓ Koalicioni i anëtarëve të tjerë të familjes me kryesin.
- ✓ Mbajtja e ligjshme apo e paligjshme dhe/ose përdorimi i armëve ose kërcënimi për përdorim të armëve.
- ✓ Konsumimi i alkoolit ose ilaçeve mund të shpengojë sjelljet dhe të çojë në përshkallëzimin e dhunës.
- ✓ Kërcënimet, në veçanti, kërcënimet për vrasje duhet të merren seriozisht.
- ✓ Xhelozia dhe posesiviteti ekstrem.
- ✓ Konceptet dhe qëndrimet jashtëzakonisht patriarkale.
- ✓ Persekutimi dhe terrori psikologjik (përndjekja).
- ✓ Mosrespektimi i urdhrave të ndalimit nga gjykatat ose policia.

Faktorë të mundshëm nxitës që mund të çojnë në përshkallëzim të papritur të dhunës (ndryshime në marrëdhënie).

---

<sup>26</sup> Shih: Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, pjesë e reagimit multi-sektorial ndaj Procedurave Standarde të Veprimit për DHBGJ, UNFPA, 2015 [https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs\\_psycho-social%20services\\_eng.pdf](https://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs_psycho-social%20services_eng.pdf) (qasur në shkurt të vitit 2021)

## Ndikimi i dhunës tek gratë<sup>27</sup>

### Pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të përvojave të dhunës tek gratë

**Gratë ose fëmijët viktimë të dhunës nuk janë vetëm subjekte të dhunës, që durojnë pasivisht dhunën, por edhe agjentë aktivë, që manovrojnë brenda situatës së vështirë, në përpjekje që ta parandalojnë, rezistojnë dhe të ballafaqohen me dhunën që përjetojnë.**

*Përvojat e viktimave të dhunës, të rritur e fëmijë, janë burim i rëndësishëm informacioni, prandaj ata duhet të fuqizohen dhe trajtohen me respekt nga profesionistët të cilët janë në kontakt me ta.*

**Pasojat afatshkurtra** janë ato fizike, që rrjedhin nga lëndimi ndaj të cilit është ekspozuar fizikisht viktimë, si dhe përfshijnë mavijosje, vrahje, shqyerje, gërvishtje, lëndime të tjera.

Është konstatuar që gratë që vuajnë nga dhuna, krahasuar me gratë që nuk i nënshtrohen dhunës, kanë dy herë më shumë gjasa të vuajnë nga problemet shëndetësore.

**Lëndimi psikologjik** ka ndikim shkatërrues mbi viktimën. Dhuna shkakton reagime emocionale, si frika nga turpërimi, ndjenja e fajit ose turpit.

**Pasojat afatgjata** mund të jenë pasoja sociale, ekonomike, fizike dhe psikologjike.

Viktimat që janë të varura financiarisht nga keqtrajtuesi i tyre, mund të gjenden në situatë të pasigurt. Ndonjëherë, gratë viktimë të dhunës humbin vendin e punës, pasi keqtrajtuesi i ngacmon ato në vendin e tyre të punës.

**Viktimat e dhunës seksuale** vuajnë pasoja afatgjata psikologjike, duke përfshirë ankthin, humbjen e vetëbesimit dhe ndjenjën e dobësisë. Të gjitha këto pasoja kanë gjasë të pasqyrojnë një model ose të përsërisin viktimizimin nga dhuna e partnerit intim.

---

<sup>27</sup> Shih materialin trajnues HELP të Këshillit të Evropës për dhunën ndaj grave. Gjetet tek: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/help-online-course>. (Qasur më 28 dhjetor 2020).

## Fëmijët viktima të dhunës në familje<sup>28</sup>

Fëmijët që ekspozohen ndaj një mjedisi të dhunshëm konsiderohen gjithashtu viktima. Fëmijët e grave që përjetojnë dhunë nga partneri preken gjithashtu nga dhuna, duke vuajtur drejtpërdrejt vetë nga abuzimi<sup>29</sup>. Fëmijët mund të ekspozohen ndaj dhunës nga të njëjtit kryes të veprës ose nga persona të tjerë me të cilët ata ndajnë vendbanimin.

Kur merret parasysh **interesi më i mirë i fëmijës**, është e rëndësishme të merren parasysh të gjitha incidentet e njohura të dhunës.<sup>30</sup>

Prandaj, ata kanë nevojë për shërbime të përgjithshme dhe të veçanta mbështetëse<sup>31</sup>. Për më tepër, mbrojtja dhe mbështetja për fëmijët dëshmitarë<sup>32</sup> duhet të sigurohet gjithmonë duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Masat tjera, si largimi i përkohshëm apo i përhershëm i fëmijës nga familja, duhet të shihen si masa të fundit, ndërsa urdhrat emergjentë të ndalimit ose urdhrat e mbrojtjes duhet të kenë përparësi.

Është e nevojshme të mbështeten gratë dhe fëmijët në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke ofruar qasje në të gjitha shërbimet përkatëse, si strehimi i sigurt, qasja në kujdesin shëndetësor, qasja në arsim dhe fuqizimi ekonomik, duke përfshirë sigurimin e mirëqenies së fëmijëve pa i ndarë nga nëna.

### Pasojat afatshkurtra të dhunës ndaj fëmijëve<sup>33</sup>:

Fëmijët në shtëpitë ku njëri prind keqtrajtohet mund të ndjehen të frikësuar dhe të shqetësuar. Ata mund të jenë gjithmonë të alarmuar, duke menduar se kur do të ndodhë ngjarja tjetër e dhunshme. Fëmijët reagojnë në mënyra të ndryshme, varësisht nga mosha e tyre:

**Fëmijët në moshën parashkollore.** Fëmijët e vegjël që janë dëshmitarë të dhunës ndaj partnerit intim mund të kthehen tek gjërat që kanë bërë më parë kur kanë qenë më të vegjël, siç janë urinimi në shtrat, thithja e gishtit të madh, rritje të të qarave, si rënkimet. Ata mund të zhvillojnë edhe vështirësi në të rënit në gjumë, ose në fjetje; të tregojnë shenja të tmerrit, si belbëzimi ose fshehja; si dhe tregojnë shenja të ankthit të rëndë të ndarjes.

---

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Shih nenin 31,1, Mbrojtja, të drejtat e vizitave dhe siguria, Konventa e Stambollit.

<sup>31</sup> Shih nenin 20 - Shërbimet e përgjithshme të mbështetjes dhe nenin 23 - Shërbimet e specializuara të mbështetjes, Konventa e Stambollit.

<sup>32</sup> Shih nenin 26.2 - Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë, Konventa e Stambollit.

<sup>33</sup> Shih 'Efektet e dhunës në familje mbi fëmijët'. Zyra për Shëndetin e Gruas (OWH), Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore. Gjetet tek <https://www.womenshealth.gov/relationships-and-safety/domestic-violence/effects-domestic-violence-children>. (Qasur më 28 dhjetor 2020).

**Fëmijët e moshës shkollore.** Fëmijët e kësaj moshe mund të ndjehen fajtorë për keqtrajtimin dhe të fajësojnë veten për të. Dhuna dhe abuzimi në familje dëmton vetëbesimin e fëmijëve. Ata mund të mos marrin pjesë në aktivitete shkollore ose përjetojnë zbehje të interesimit për mësim, kanë më pak miq se të tjerët dhe të futen në telashe më shpesh. Mund të kenë edhe më shumë dhimbje koke dhe dhimbje stomaku.

**Adoleshentët.** Adoleshentët që janë dëshmitarë të abuzimit mund të veprojnë në mënyra negative, të tilla si fjalosjet me anëtarë të familjes ose mungesat në shkollë. Ata gjithashtu mund të hyjnë në veprime të rrezikshme, siç janë marrëdhëniet seksuale të pambrojtura dhe përdorimi i alkoolit ose drogave. Ata mund të kenë vetëbesim të ulët dhe të kenë probleme të krijuara nga raportet shoqërore. Ata mund të krijojnë dhe iniciojnë konflikte ose të ngacmojnë të tjerët, si dhe ka më shumë të ngjarë të kenë probleme me ligjin. Kjo lloj sjelljeje është më e zakonshme tek djemtë adoleshentë që janë ekspozuar ndaj abuzimit gjatë fëmijërisë së tyre, sesa tek vajzat adoleshente. Vajzat kanë më shumë gjasë të jenë të tërhequra dhe të përjetojnë depresion, sesa djemtë.

### **Pasoja afatgjata të dhunës ndaj fëmijëve<sup>34</sup>:**

Fëmijët kanë rrezik më të madh të përsërisin ciklin si të rritur, duke hyrë në marrëdhënie abuzive ose duke u bërë vetë abuzues.

Fëmijët që ekspozohen ose janë viktimë të abuzimit emocional, fizik ose seksual, kanë rrezikshmëri më të lartë të problemeve shëndetësore si të rritur. Këto mund të kenë probleme me shëndetin mendor, si depresioni dhe ankthi. Ato mund të jenë edhe diabet, mbipeshë, sëmundje të zemrës, vetëbesim i dobët dhe probleme të tjera.

Barrierat e identifikuara për raportimin e dhunës:

- Turpi dhe stigmatizimi: qoftë për shkak të natyrës së përvojave të tyre, ose sepse besuan se njerëzit do t'i fajësonin ato për dhunën.
- Dëshira për të mos u ndarë nga fëmijët e tyre: duke qenë se ato supozonin se fëmijët e tyre do të qëndronin me babanë e tyre.
- Mungesa e pavarësisë financiare: gjë që do t'i parandalonte ato të largoheshin nga një marrëdhënie.
- Frika nga pasojat nga partneri i tyre: duke qenë se ato mendonin se policia ose ligji nuk do t'i mbronte ato.
- Mungesa e besimit në institucione: besimi se dhuna nga partneri intim lejohet.

---

<sup>34</sup> Po aty.

## II. Korniza ligjore dhe e politikave e Kosovës për dhunën në familje

### Kushtetuta e Kosovës - Neni 50 [Të drejtat e fëmijës]<sup>35</sup>

1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
2. Fëmijët e lindur jashtë martesë, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.
3. Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.
4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.
5. Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

**Kodi Penal** - Në përputhje me Kodin e ri Penal të Kosovës (KPK), që hyri në fuqi në prill të vitit 2019, **dhuna në familje dhe ngacmimi seksual janë vepra të veçanta penale.**

Neni 248 i KPK përcakton se "*Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 (tre) vjet.*"<sup>36</sup>

Për më tepër, neni 183 gjithashtu e përkufizon ngacmimin seksual si "*cilëndo formë të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.*"<sup>37</sup>

**Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje** - ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.<sup>38</sup>

<sup>35</sup>Shih nenin 50 të Kushtetutës, 15 qershor 2008, dhe ndryshimet në kushtetutë, 7 shtator 2012; 26 mars 2013; 5 gusht 2015; 11 mars 2016 dhe 25 shtator 2020.

<sup>36</sup>Shih nenin 248 të Kodit Nr. 06 / L-074, Kodi Penal i Kosovës (KPK), janar 2019.

<sup>37</sup>Shih nenin 183, paragrafin 2 të KPK-së. Shih edhe nenin 3 të Ligjit Nr. 05 / L -020 për Barazinë Gjinore në Kosovë, qershor 2015.

<sup>38</sup>Shih nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.



**Ligji për barazi gjinore - neni 3, paragrafi 1.18. dhuna në baza gjinore**- nënkupton të gjitha aktet e dhunës që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike, sociale apo ekonomike në baza gjinore, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim, apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo ndodh në jetën publike apo private.<sup>39</sup>

**Ligji për shërbimet sociale dhe familjare** - përcakton dhe rregullon sigurimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat që janë në nevojë të shërbimeve sociale dhe familjare<sup>40</sup> dhe familjet në nevojë në Kosovë.

**Ligji për familjen i Kosovës<sup>41</sup>** - rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësimin), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës për kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.

**Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësit të dhunës në familje** - rregullon dhe përcakton vendin dhe mënyrën e zbatimit të trajtimit psikosocial të një kryerësi të dhunës në familje me qëllim të parandalimit apo nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.<sup>42</sup>

**Udhëzimi Administrativ për trajtimin e detyrueshëm mjekësor të kryerësit të dhunës në familje të cilët janë të varur nga alkooli dhe substancat psikotrope<sup>43</sup>** - rregullon trajtimin e detyrueshëm mjekësor të kryerësve të dhunës në familje të cilët janë të varur nga alkooli dhe substancat e tjera psikotrope.

**Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë<sup>44</sup>** përshkruajnë mekanizmat institucionalë që janë drejtpërdrejtë të përfshirë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Ato më tej shpjegojnë përgjegjësitë e tyre në katër fazat e reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje, të cilat janë: identifikimi (raportimi), referimi, mbrojtja, ri-integrimi dhe rehabilitimi.

---

<sup>39</sup>Shih nenin 3, paragrafin 1.18 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, qershor 2015.

<sup>40</sup>Shih nenin 1, paragrafin 1.1 të Ligjit 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, maj 2007 dhe ndryshim-plotësimin e tij me Ligjin Nr. 04/ L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02 / L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, prill 2012.

<sup>41</sup>Ligji Nr. 2004/32, Ligji për Familjen i Kosovës, shtator 2006 dhe ndryshim-plotësimet e tij me anë të Ligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Familjen të Kosovës nr. 2004/32, mars 2019.

<sup>42</sup>Shih nenin 1 të *Udhëzimit administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësit të dhunës në familje*, tetor 2010.

<sup>43</sup>Shih *Udhëzimin Administrativ (Shëndetësor) Nr. 02/2013 për Metodën e Trajtimit të Kryerësit të Dhunës në Familje ndaj të cilëve është shqiptuar Masa e Trajtimit të Detyrueshëm Mjekësor nga Alkooli dhe Varësia nga Substancat Psikotrope*, shkurt 2013.

<sup>44</sup>Shih *Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë*.

**Strategjia e Kosovës për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Plani i veprimit 2016 - 2020<sup>45</sup>** - zbatimi i strategjisë mëton që të konsolidojë reagimin e palëve të interesuara dhe ofruesve të shërbimeve duke (i) forcuar mekanizmat ekzistues institucionalë dhe duke krijuar mekanizma të rinj institucionalë për reagim efikas ndaj viktimave të dhunës në familje; (ii) bashkërenduar veprimet dhe duke siguruar qëndrueshmërinë financiare për të parandaluar, mbrojtur, trajtuar, rehabilituar dhe ri-integruar viktimat; (iii) ndërmarr masat e duhura për të ndëshkuar (ndjekur penalisht) dhe për rehabilituar vazhdimisht kryerësit e dhunës; si dhe duke (iv) organizuar aktivitete informative dhe fushata ndërgjegjësimi.

### **III. Roli i zyrtarëve të shërbimit social në trajtimin e rasteve të dhunës në familje**

#### **Roli dhe përgjegjësitë e qendrës për punë sociale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje<sup>46</sup>**

Qendra për Punë Sociale kontakton viktimën e rritur dhe të mitur menjëherë pasi rasti i dhunës në familje të referohet nga policia dhe palët e tjera të interesuara në sistemin e referimit.

Çdo viktimitë të referuar i caktohet një Menaxher Rasti, i cili është profesionist brenda QPS-së dhe emërohet nga QPS-ja për ta udhëhequr procesin e mbrojtjes së viktimës/të mbijetuarit në identifikimin, koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve ekzistuese sociale.

Në rastet kur fëmijët janë viktimat e dhunës në familje nga prindërit ose kujdestarët biologjikë, Organi i Kujdestarisë brenda QPS-së cakton një kujdestar ligjor i cili do të përfaqësojë dhe mbrojë interesat më të mira të fëmijës.

---

<sup>45</sup> Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016 - 2020.

<sup>46</sup> Shih Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, faqe 37, 38, 39 dhe 67. [Shih edhe](#) *Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, pjesë e përgjigjes multi-sektoriale ndaj DHBGJ - Procedurat Standarde të Veprimit*, Zyra Rajonale e UNFPA për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (UNFPA EECARO), 2015. Identifikimi - faqe 14 dhe 15; Referimi - faqe 22 dhe 23; Dokumentimi - faqe 21 dhe 22. Në dispozicion në: [https://eeeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs\\_psychosocial%20services\\_eng.pdf](https://eeeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/SOPs_psychosocial%20services_eng.pdf).

## IDENTIFIKIMI

- Reagoni menjëherë ndaj rasteve të dhunës në familje kur të njoftoheni nga policia ose ofruesit e tjerë të shërbimeve.
- Njoftoni policinë nëse rastet janë referuar drejtpërdrejtë apo janë vetë-referuar në Qendrën për Punë Sociale.
- Ofroni asistencë të menjëhershme për viktimën.
- Mbani intervistë vetëm me viktimën/të mbijetuarin e DHF, pa praninë e kryerësit, anëtarit të familjes, të afërmeve, miqve të ngushtë ose ndonjë personi tjetër.
- Përshëndetni personin me ngrohtësi.
- Prezantohuni dhe shpjegoni shkurtimisht mandatin/shërbimet e institucionit.
- Kërkojini me mirësi personit që ta prezantojë veten e tij/saj.
- Shmangni çdo kontakt fizik me viktimën/të mbijetuarin ose personat shoqërues, si dhe çdo lëvizje të papritur. Kjo mund të jetë stresuese për viktimat/të mbijetuarit e DHF, veçanërisht për ata që vuajnë nga dhuna fizike.
- Pyesni personin nëse parapëlqen që të ndihmohet nga një këshilltar i së njëjtës gjini (sidomos në rastet e dhunës seksuale).
- Jepni viktimës/të mbijetuarit të DHF mundësinë për të parashtruar pyetje për çdo gjë që ai/ajo mund ta konsiderojë si të rëndësishme.
- Mbani në mend nevojat e grupeve të ndryshme të popullsisë (p.sh., personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, personat fetarë dhe pakicat etnike) dhe bëni përpjekje për t'i trajtuar ato.
- Krijoni mjedis të besueshëm dhe të dhembshur, dëgjoni në mënyrë aktive personin dhe jepni mesazhe konfirmimi (ju lutemi referojuni pjesëve: Si të punojmë me një viktimë/të mbijetuar të DHF, dhe mjedisi e punës).
- Fitoni besimin e viktimës/të mbijetuarit të DHF.
- Njoftoni viktimën/të mbijetuarin e DHF për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion.
- Respektoni periudhën e reflektimit për 48 orë. *Periudha prej 48 orëve llogaritet nga strehimi i viktimës në strehimore ose ndonjë vend tjetër të sigurt, që i jepet viktimës nga ofruesit e shërbimeve për t'u përshtatur në mjedisin e ri pa ndërhyrje. Kjo periudhë synon t'i sigurojë viktimës/të mbijetuarit të DHF një periudhë qetësie dhe reflektimi derisa viktimat/i mbijetuarit i DHF të njoftohet me shërbimet në dispozicion, rregullat e strehimit dhe derisa ato t'i referohen shërbimeve të tjera<sup>47</sup>.*
- Vlerësoni gjendjen dhe situatën sociale dhe ekonomike të viktimave/të mbijetuarve të DHF.

---

<sup>47</sup>Procedurat standarde të veprimit për viktimat e dhunës në familje në Kosovë, faqe 9.

Vizitoni familjen e viktimave/të mbijetuarve të DHF për të vlerësuar sigurinë e viktimës/të mbijetuarit dhe fëmijëve të tyre. Respektoni kërkesën e viktimës për të mos e takuar kryerësin e dhunës në familje.

Vizitoni familjen e viktimave/të mbijetuarve të DHF për të vlerësuar sigurinë e viktimës/të mbijetuarit dhe fëmijëve të tyre. Respektoni kërkesën e viktimës për të mos e takuar kryerësin e dhunës në familje.

## **REFERIMI**

- Vlerësoni se çfarë referimi mund të jetë i dobishëm për viktimën/të mbijetuarin e Dhunës në Familje, në përputhje me nevojat dhe dëshirat.
- Njoftoni viktimën për shërbimet në dispozicion nga institucionet dhe ofruesit e shërbimeve që ofrojnë avokim, shërbime të ndihmës juridike falas, shërbime rehabilitimi dhe riintegrimi dhe programe për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje.
- Merrni pëlqimin e viktimës/të mbijetuarit për ta bërë referimin, para çdo hapi tjetër.
- Sqaroni me viktimën/të mbijetuarin e DHF se çfarë informacioni do të ndahet me ofruesit e tjerë të shërbimeve dhe se cilat informacione do të mbahen të fshehta (saktësoni nëse ekziston ndonjë rregullim/kufizim ligjor).
- Jepni viktimës/të mbijetuarit të DHF informata të plota dhe të sakta në lidhje me ofruesit e shërbimeve, duke ndjekur skemën e tre pyetjeve (3W) të përshkruar më poshtë:

**KUSH** - cili institucion/organizatë ofron shërbime për viktimat/të mbijetuarit e DHF, duke dhënë informatat kontaktuese të personit (emri, numri i telefonit) që duhet të kontaktohet si person kontaktues në atë shërbim.

**ÇKA** - çfarë lloj ndihme mund të presin të marrin nga një ofrues i veçantë i shërbimit, duke dhënë informatat për koston që lidhen me atë shërbim.

**KU** - ku është saktësisht vendi (adresa e saktë) e shërbimeve në fjalë.

- Bëjeni referimin sipas zgjedhjes që e bën viktimë/i mbijetuar i DHF. Mos e shtyni viktimën/të mbijetuarin që të ndër marrë ndonjë veprim me të cilin ai/ajo nuk ndjehet rehat.
- Shoqërojeni referimin me një raport të shkurtër, të shkruar dhe me një bisedë telefonike me ofruesin tjetër të shërbimit, si metodë për të shmangur situatën kur viktimë/i mbijetuar duhet ta përsërisë historinë dhe t'i përgjigjet të njëjtave pyetje

gjatë intervistave të shumta, duke rijetuar përsëri traumën psikologjike të shkaktuar nga incidenti i DHF.

- Inkurajoni pavarësinë e viktimës/të mbijetuarit duke e fuqizuar atë që ai/ajo vetë ta bëjë referimin.
- Shoqëroni viktimën/të mbijetuarin te ofruesi i shërbimit të referuar, nëse është e nevojshme dhe e mundshme.
- Shpjegojani se për çfarë arsye provat e mbledhura mund të jenë të rëndësishme/të dobishme. Pyeteni viktimën/të mbijetuarën e DHF nëse ajo/ai dëshiron që të mblidhen provat e dhunës. Mbajeni mend rëndësinë e mbledhjes sa më të shpejt të provave në situatat e veçanta të DHF (p.sh., në rastet e dhunës seksuale).
- Shpjegojani se çfarë duhet të bëhet dhe çfarë duhet të shmanget me qëllim që të ruhen/që të mos shkatërrohen provat (p.sh., që të mos pastrohen, që të mos i ndërrojnë rrobat). Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme në rastet e sulmeve seksuale dhe përdhunimeve.
- Në përputhje me nevojat dhe dëshirat, referoni viktimën/të mbijetuarin në shërbime të tjera.
- Referoni viktimën tek institucionin përkatës ose Policia e Kosovës – Sektori kundër dhunës në familje ose shërbimi tjetër përkatës; strehimorja, mbrojtësi i viktimës.
- Menaxheri i rastit i QPS-së duhet të plotësojë Formularin e të dhënave themelore<sup>48</sup> për viktimën dhe t'ia dorëzojë atë Policisë ose ofruesve të tjerë të shërbimeve.
- Nëse viktima/i mbijetuari i DHF dhe fëmijët e tyre janë në rrezik ose ndihen të pasigurt, siguroni strehim të sigurt alternativ në strehimore ose në ndonjë objekt tjetër.

## **MBROJTJA**

- Zhvilloni planin individual së bashku me viktimën/të mbijetuarin e DHF duke respektuar periudhën e reflektimit prej 48 orëve.
- Njoftoni viktimën/të mbijetuarin e DHF për kualifikimin për shërbime sociale.
- Jepni këshilla viktimës/të mbijetuarit të DHF për shërbimet dhe kërkesat.
- Ndërgjegjësoni viktimën/të mbijetuarin e DHF për atë se çka përbën dhunë në familje dhe ndikimin që mund të ketë keqtrajtimi i tillë tek fëmijët.
- Kuptoni pengesat psikologjike me të cilat përballen gratë në situata të dhunshme, veçanërisht në lidhje me përparësinë që ju japin mirëqenies së fëmijëve të tyre.
- Ndërtoni besim të ndërsjellë mes zyrtarëve të shërbimit social dhe viktimës/të mbijetuarit të DHF.
- Mbështetni viktimën/të mbijetuarin e DHF për t'ia rritur vetëbesimin dhe jepni përparësi nevojave të viktimave/të mbijetuarave dhe fëmijëve.

---

<sup>48</sup>Procedurat standarde të veprimit për viktimat e dhunës në familje në Kosovë, faqe 69.

- Përqendrohuni tek forca e viktimës/të mbijetuarit të DHF: Viktima/i mbijetuari i DHF mund të ndihet se nuk është në gjendje që të largohet nga marrëdhënia e tij/saj për shkak të ndikimeve emocionale, ekonomike dhe sociale të dhunës në familje.
- Në rast se viktima/ i mbijetuari i DHF kthehet në marrëdhënien abuzive, mos i gjykoni ata, ofroni atyre ndihmë të hapur sa herë që dëshirojnë të largohen.
- Kuptojeni frustrimin, dobësinë dhe frikën e tyre.
- Punoni drejtpërdrejt me fëmijët për të forcuar marrëdhënien prind-fëmijë, duke qenë se mund të ndikohet keq nga dhuna në familje - veçanërisht nëse viktima ndahet nga një partner i dhunshëm.
- Kuptoni ndikimin e dhunës në familje në shëndetin mendor të prindërve dhe në shkathtësitë e tyre prindërore.
- Zbatoni masat e trajtimit psikosocial që shqiptohen nga gjykata.
- Respektoni fshehtësinë. **Zbulimi i faktit se ka pasur një raportim ose dyshim se një person ka pësuar dhunë në familje është potencialisht i dëmshëm për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje. Përveç kësaj, siguria dhe mirëqenia e viktimës/të mbijetuarit të DHF mund të rrezikohet nëse kryerësi vihet në dijeni se viktima e ka raportuar.**
- Njoftojeni viktimën/të mbijetuarin e DHF se të gjitha informacionet e dhëna do të mbahen fshehtë dhe se nuk do të zbulohen në asnjë moment, përfshirë edhe pas ndjekjes penale të kryerësit ose pas eliminimit të kërcënimit.
- Informacioni i **fshehtë** do të zbulohet vetëm me lejen e tyre ose nëse është e nevojshme për të kërkuar ndihmë të mëtejshme ose për të garantuar sigurinë e tyre.

## DOKUMENTIMI

- Mblidhni dhe regjistroni informacione në lidhje me viktimën/të mbijetuarin/ rastin e DHF duke përfshirë: emrin, moshën, gjininë, statusin martesor, hollësi për kujdestarinë e fëmijëve, historikun e shëndetit mendor, konsumimin e substancave dhe ilaçeve, anëtarët e familjes dhe raportet mes tyre, informacion në lidhje me statusin socio-ekonomik të viktimës/të mbijetuarit/ familjes, pëlqimin e dhënë.
- Mblidhni dhe regjistroni hollësitë e plota të incidentit të DHF dhe historinë e dhunës duke përfshirë:
  - provat për të mbështetur veprën e pretenduar;
  - historinë e ndonjë incidenti tjetër, përfshirë atë me partnerët e mëparshëm;
  - raportet mes viktimës/të mbijetuarit dhe kryesit;
  - llojin e dhunës dhe shpeshtësinë e ngjarjeve;
  - nëse janë përdorur armët (si dhe çfarë lloji, nëse është e mundshme);
  - dëshmitarët e pranishëm gjatë incidentit, përfshirë fëmijët.

- Përshkruani në hollësi pasojat/ndikimin e dhunës (fizike, psikologjike dhe sociale).
- Përshkruani faktorët e rrezikut dhe të mbrojtjes (personal dhe social/ mjedisor).
- Regjistroni veprimet që planifikohen ose që janë ndërmarr për të trajtuar situatën e dhunshme.
- Shënoni planifikimin e sigurisë dhe karakteristikat e rastit në këtë çështje.
- Gjatë seancave këshilluese pasuese, mblidhni të dhëna në lidhje me zhvillimin e rastit.
- Vini re se çka zbulon viktimat/i mbijetuarit duke përdorur fjalët e veta.
- Dokumentoni dyshimet tuaja dhe provat në të cilat ato bazohen.
- Njoftoni viktimat/të mbijetuarit në lidhje me përdorimin e mundshëm të shënimeve dhe merrni pëlqimin për këtë.
- Mbani të gjitha shënimet në vend të sigurt dhe fshehtë. Udhëzimet e vendosura në çdo vend do të përcaktojnë se sa gjithëpërfshirës duhet të jetë informacioni.
- Ndani kohë të duhur për të futur të dhëna në sistemin e mbledhjes së të dhënave.

### **BASHKËRENDIMI**

- Bashkërendoni aktivitetet me partnerë të tjerë për të ri-integruar viktimën/ të mbijetuarin e DHF. Organi i kujdestarisë që vepron brenda QPS-së jep mendim profesional nëse kërkohet nga organet e drejtësisë pra gjykata, prokuroria dhe policia. Së bashku me palët e tjera të interesuara, të hartohet plan i përkohshëm i sigurisë për viktimat/të mbijetuarit e DHF.

### **SHËRBIMET SOCIALE QË I SIGUROHEN VIKTIMËS/TË MBIJETUARIT TË DHF**

- Siguroni rehabilitim të viktimës/të mbijetuarit të dhunës në familje.
- Kujdestaria.
- Siguroni strehim afatshkurtër nëse është e nevojshme për t'i dhënë siguri viktimës.
- Jepni mbështetje për asistencën sociale.
- Mbështetni viktimën/të mbijetuarin e DHF për të nxjerrë dokumentet personale dhe dokumentet e tjera administrative.

## **Roli i zyrtarëve të shërbimit social për trajtimin e fëmijëve viktimë/të mbijetuar të dhunës në familje:**

*Zyrtari i shërbimit social duhet të ndër marrë masa të veçanta për të ndihmuar fëmijën viktimë/të mbijetuar të dhunës në familje*

### **IDENTIFIKIMI**

- Caktoni menaxherin e rastit.
- Nëse ka arsye për të besuar se ka kërcënim serioz direkt për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, Organi i Kujdestarisë mund të futet në çdo lokacion dhe ta zhvendos fëmijën në një vend të sigurt dhe të ofrojë kujdes për një periudhë jo më të gjatë se 72 orë.
- Organi i kujdestarisë është i pranishëm në intervistën e parë në stacionin e policisë.

### **REFERIMI**

- Referojeni viktimën/të mbijetuarin e dhunës në familje në strehimore. Djemtë deri në moshën 12 vjeçare, viktimë të dhunës në familje, mund të vendosen në strehimoret rajonale të dhunës në familje<sup>49</sup>. Mirëpo djemtë mbi moshën 12 vjeçare, viktimë të dhunës në familje, mund të referohen në organizata joqeveritare, strehimore të specializuara për mbrojtje të fëmijëve.
- Kur një fëmijë, viktimë e dhunës në familje vendoset në strehimore dhe ka nevojë për shërbime shëndetësore, organi i kujdestarisë duhet t'i përgjigjet ftesës së strehimores për ta çuar viktimën në institucionet e kujdesit shëndetësor.

### **MBROJTJA**

- QPS mund ta parashtrojë kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente në gjykatën e komunës përkatëse ku banon viktimë.
- Fëmija mund t'i merret familjes në rast se ka vlerësim të rrezikut - pa vendim gjykate deri në 72 orë. Para përfundimit të periudhës 72-orëshe, Organi i Kujdestarisë duhet ta paraqesë rastin në gjykatën kompetente, e cila do të vendosë për kujdestarinë e fëmijës. Nëse rrethanat e kërkojnë këtë, gjykata mund të lëshojë një urdhër për vlerësim në një periudhë prej 21 ditësh, për të mundësuar hetimin dhe vlerësimin e mëtejshëm, deri në të cilën kohë rasti duhet t'i paraqitet gjykatës për shqyrtim të mëtejshëm. Kjo periudhë kujdestarie e fëmijës nuk përjashton të drejtat e tjera të prindërve, as detyrat e tyre ndaj fëmijës
- Vlerësimi i kapacitetit prindëror duhet të bëhet duke e vlerësuar secilin rast dhe situatë veç e veç.

---

<sup>49</sup>Në Kosovë ekzistojnë tetë strehimore për viktimat e dhunës në familje përfshirë strehimoren rajonale për rastet e dhunës në familje në Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Novobërdë, Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë të jugut.



- Menaxheri i rastit konsultohet me kujdestarin ligjor në lidhje me vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën.
- Për vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me shëndetin, arsimin dhe pasuritë - menaxheri i rastit duhet të sigurojë formularët e mbrojtjes.

## **BASHKËRENDIMI**

- Bashkërendoni aktivitetet me partnerë të tjerë për të riintegruar fëmijët viktime të dhunës në familje.
- Organi i kujdestarisë që vepron brenda QPS-së jep mendim profesional nëse kërkohet nga organet e drejtësisë dhe gjykata, prokuroria dhe policia.
- QPS-të e ushtrojnë rolin e organit të kujdestarisë dhe përfaqësojnë interesin më të mirë të fëmijës në të gjitha llojet e kontesteve që përfshijnë fëmijët, përfshirë rastet e dhunës në familje. Në këtë cilësi, atyre u kërkohet gjithmonë që të hartojnë mendim me shkrim për çdo rast dhe që ta paraqesin atë në gjykatë përpara gjykimit të cilitdo rast.
- Së bashku me palët e tjera të interesuara, të hartohet plan i përkohshëm i sigurisë për viktimat/të mbijetuarit e DHF.

Zyrtarët e shërbimit social duhet të kenë pajisjet e mbrojtjes personale kundër COVID-19 kur janë në kontakt me gratë, fëmijët, të moshuarit dhe të rinjtë që janë në pozitë të cenushme dhe duhet të kryejnë punën e tyre në bazë të udhëzimeve dhe këshillave të Institutit të Shëndetit Publik (ISHP).<sup>50</sup>

---

<sup>50</sup>Shikoni *Udhëzuesin e Përkohshëm për Zbatimin e Masave për Parandalimin dhe Luftimin e COVID-19 në Institucionet Publike dhe Private*, maj 2020. Në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/6B4B25D1-4478-4FBF-98F1-6148C818F968.pdf>.

## IV. Shtojca: Instrumentet dhe parimet kryesore ndërkombëtare mbi dhunën ndaj grave:

Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), 1982. Në dispozicion në:

<https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/committee.htm>. [qasur më 23 mars 2021]

Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 48/104, dhjetor 1993. Në dispozicion në:

[https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocity-crimes/Doc.21\\_declaration%20elimination%20vaw.pdf](https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocity-crimes/Doc.21_declaration%20elimination%20vaw.pdf). [qasur më 23 mars 2021]

Deklarata dhe Platforma e Veprimit e Pekinit, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW), 1979. Në dispozicion në:

[https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing\\_Declaration\\_and\\_Platform\\_for\\_Action.pdf](https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing_Declaration_and_Platform_for_Action.pdf). [Qasur më 23 mars 2021]

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 44/25, nëntor 1989: Në dispozicion në:

<https://www.ohchr.org/documents/professionalinterest/crc.pdf>. [qasur më 23 mars 2021]

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Stamboll 2011. Në dispozicion në:

<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210>. [qasur më 23 mars 2021]

